



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Punëve të Jashtme - Ministarstvo Inostranih Poslova
Ministry of Foreign Affairs



College of Europe
Collège d'Europe



MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT

NDËRMJET

AKADEMISË DIPLOMATIKE TË MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

DHE

KOLEGJIT TË EVROPËS BRUGES (BELGJIKË) ¹

Akademia Diplomatike e Republikës së Kosovës dhe Kolegji i Evropës, Bruges (Belgjikë) (këtej e tutje të referuar si (“Palët”).

DUKE NJOHUR frymën e bashkëpunimit që ekziston midis dy institucioneve dhe të GATSHËM për të promovuar bashkëpunimin më të ngushtë në trajnimin e diplomatëve;

Kanë rënë dakord si në vijim:

Neni 1

Qëllimi

Objektivi i këtij Memorandumi të Mirëkuptimit (MiM) është që të krijojë kushte për mbajtjen e kontakteve të rregullta dhe promovimit të bashkëpunimit ndërmjet Palëve.

¹ KY DOKUMENT NUK ËSHTË NË GJUHËN ORIGJINALE!

Neni 2

Bashkëpunimi

Palët do të bashkëpunojnë në shkëmbimin e informatave dhe përvojave përkitazi me programet e tyre përkatëse të studimit dhe hulumtimit, seminareve dhe aktiviteteve tjera akademike dhe të trajnimit.

Palët mund të eksplorojnë mundësitë e formave të tjera të bashkëpunimit në kuadër të objektivave të këtij memorandumi.

Neni 3

Çështjet me interes të përbashkët

Palët do të promovojnë, kontaktojnë dhe shkëmbejnë trajnerë, ekspertë dhe hulumtues.

Palët do të inkurajojnë studimet dhe hulumtimet, si dhe shkëmbimin e informatave mbi publikimet kombëtare dhe ndërkombëtare, veçanërisht në fushat me interes të përbashkët.

Neni 4

Shkëmbimi i informatave

Palët do të shkëmbejnë informata dhe pikëpamje në lidhje me trendet ndërkombëtare dhe përparimet në trajnim dhe studime në diplomaci, politikë të jashtme, marrëdhënie ndërkombëtare, të drejtën ndërkombëtare, marrëdhënie ekonomike me jashtë, shkenca politike si dhe fusha tjera relevante.

Neni 5

Prona Intelektuale

Asnjëra palë e këtij MiM nuk do të përdor apo t'i referohen emrit, logos ose çfarëdo emërtimi tjetër të palës tjetër pa pëlqimin paraprak me shkrim të asaj pale tjetër.

Palët bien dakord që çdo pronë intelektuale që është zhvilluar si rezultat i aktivitetit bashkëpunues do të trajtohet përmes marrëveshjeve të duhura me shkrim në kohë relevante.

Neni 6

Projektet e ndërmarra bashkërisht

Palët do të vendosin specifikat dhe logjistikën e secilit projekt që ata ndërmarrin së bashkërisht. Për këtë qëllim, nëse është e nevojshme, do të lidhen protokollat që përcaktojnë termat dhe kushtet e shkëmbimeve të propozuara.

Neni 7

Kushtet financiare

Për format, kohëzgjatjen dhe kushtet financiare të shkëmbimeve dhe trajnimit të përfaqësuesve të Nënshkruarve, do të bihet dakord ndërmjet të Nënshkruarve.

Neni 8

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet dhe kontestet lidhur më interpretimin ose zbatimin e këtij Memorandumi do të zgjidhen ndërmjet Palëve nëpërmjet konsultimeve.

Neni 8

Ndryshimet

Dispozitat e këtij Memorandumi mund të ndryshohen përmes pëlqimit reciprok me shkrim ndërmjet Palëve.

Neni 9

Hyrja në fuqi

Ky Memorandum do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit të tij, dhe do të vazhdojë të ketë efekt për një periudhë prej tre vjetësh. Pas kësaj, ky mund të ripërtërihet automatikisht për periudha të njëjta, përveç nëse ndërpritet nga ndonjëra Palë, duke i dhënë një njoftim me shkrim prej nëntëdhjetë (90) ditëve Palës tjetër, para datës së përfundimit të Memorandumit. Përfundimi i këtij Memorandumi nuk do të ndikoj në projektet që janë në vazhdim e sipër.

NË DËSHMI TË KËSAJ, të nënshkruarit, duke qenë të autorizuar për këtë, kanë nënshkruar këtë Memorandum.

BËRË në Bruges më 25.11.2015, në dy kopje origjinale, në Gjuhën Angleze, që janë njëlloj autentike.

Për Akademinë Diplomatike
të Republikës së Kosovës

Skender Durmishi, Drejtor

Për Kolegjin e Evropës
Bruges (Belgjikë)

Prof. Dr. Dr. Jorg Monar, Rektor